

V E N D I M N r. 5

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
“ALBCHROME HOLDING” SH.P.K.**

Sot, më datë 14.07.2021 (dymijë e njëzet e një), në selinë e Shoqërisë “AlbChrome Holding” Sh.p.k. me NUIS L51320005G (më tej referuar si “Shoqëria”), në adresën “Rr. Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Ap. Nr.3, Tiranë” u paraqitën palët e mëposhtme ortake të Shoqërisë:

Balfin Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, me seli në ‘Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Business Center, Kati 11, Tiranë’ përfaqësuar rregullisht nga **Znj. Edlira MUKA**, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 025864525 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton z. Fatos Kaleshi, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë (më tej referuar si “Ortaku”), zotëruese në masën 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të **Shoqërisë**, për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901, datë 14.03.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (‘Ligji nr.9901/2008’), dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

REND DITE:

1. **ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË.**
2. **TË NDRYSHME.**

Duke kaluar në diskutimin e çështjeve të rendit të ditës, Kryetari i Asamblesë parashtron se Ortaku ka kontribuar në para në Shoqëri dhe ky kontribut, është në vlerën totale prej prej 10,800,000 lekë (dhjetë milion e tetëqind mijë lekë). Duke qënë se kërkohet kapitalizimi i kontributeve të dhëna nga Ortaku, lind nevoja për miratimin e rritjes së kapitalit nëpërmjet kontributit në para të Ortakut, i shlyer plotësisht, duke e zmadhuar vlerën e kapitalit të Shoqërisë me prej 10,800,000 lekë (dhjetë milion e tetëqind mijë lekë).

Pas një vlerësimi të kujdesshëm të të gjitha parashtrimeve dhe diskutimeve të zhvilluara, Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI:

1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë me kontributin e shlyer në para në një vlerë të barabartë me 10,800,000 (dhjetë milion e tetëqind mijë lekë) lekë.
2. Kapitali i Shoqërisë nga nga 535,232,268 (pesëqind e tridhjetë e pesë milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë lekë) lekë,

bëhet:


546,032,268 (pesëqind e dyzetë e gjashtë milion e tridhjetë e dy mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë leke) lekë, i cili zotërohet 100% (njëqind përqind) nga Ortaku Balfin Shpk.

3. Autorizohet Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë, znj. Blerina DAKA, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

Meqënëse nuk kishte cështje të tjera për të shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme të "Albchrome Holding" Sh.p.k. mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901/2008 dhe nënshkruhet rregullisht nga Kryetari dhe Sekretari.


**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË
ALBCHROME HOLDING SH.P.K.**

KRYETARI


Znj. Edlira MUKA



SEKRETARI


z/ Fatos KALESHI